



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA -GOVERNMENT

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural / Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja / Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development*

Duke u bazuar në nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, dhe nenin 8, paragrafi 8.1, 8.2 dhe 8.5 të Ligjit Nr. 2004/21 për Veterinarinë të dt. 30 Korrik 2004, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Nxjerr sa vijon:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 06/2008
Për parandalimin, kontrollin, luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së
Plasjes – Anthrax-it

Neni 1

Qëllimi

Me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve me këtë udhëzim administrativ, përcaktohen masat veterinarë të cilat autoriteti kompetent do t'i ndërmarr për parandalimin, kontrollin, luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së Plasjes tek kafshët.

Neni 2

Përkufizimet

Për kuptimin e këtij udhëzimi administrativ, termat e përdorur në të kanë këtë domethënie:
“**Pronë**”- nënkupton vendin, ndërtesën, fermën e hapur apo ndonjë vend tjetër në të cilin mbahen ose shfrytëzohen kafshët;
“**Plasja**” është sëmundje zoonotike që shfaqet tek kafshët e cila bartet nga kafshët te njerëzit dhe anasjelltas;
“**Pronar - mbajtës**”- nënkupton personin fizik apo juridik, i cili ka pronësinë mbi një apo më tepër kafshë, apo është i autorizuar që të mbajë apo përkujdeset për të;
“**Autoritet Kompetent**”- nënkupton Agjencinë e Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës – AVUK;
“**Veterinar i autorizuar**”- nënkupton veterinarin e autorizuar nga autoriteti kompetent për kryerjen e aktiviteteve publike veterinarë;
“**Laborator Referent**”- nënkupton laboratorin i cili është i licencuar nga autoritetet e BE-së për diagnostifikimin e sëmundjes së Plasjes dhe e cila gjendet në listën zyrtare të OIE-së;

“OIE”- Organizata Ndërkombëtare për Epizooti;

“DG-SANCO”- nënkupton Drejtoria Gjenerale për rautje të shëndetit publik dhe mbrojtje të konsumatorit;

“**Kafshë e dyshuar**” do të thotë çdo kafshë nga lloji i prekshëm e cila shfaq simptome klinike apo e ka prejardhjen nga regjioni në të cilin në 20 vitet e fundit është vërtetuar se ka pasur Plasje;

“**Kafshë e infektuar**” do të thotë çdo kafshë nga lloji i prekshëm, për të cilën me shenja klinike dhe me analiza laboratorike është konfirmuar Plasje;

“**Kafshë e llojit të prekshëm**” nënkupton kafshën e cila ka predispozicion për t’u infektuar me Plasje si: gjedhi, delja, dhia, derri, qeni, maca dhe kali;

“**Asgjësim**”- nënkupton asgjësimin e kufomës së kafshës në mënyrën e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;

“**Vaksinim emergjent**”- nënkupton vaksinimin në rast të shpërthimit të sëmundjes së plasjes.

Neni 3

Obligimet e autoritetit kompetent

(1) Në rast të dyshimit apo konfirmimit zyrtar të sëmundjes së plasjes, autoriteti kompetent ndërmerr veprime si vijon:

1. grumbullon informata për situatën dhe gjendjen epizootologjike përmes inspektorit veterinar dhe veterinarit të autorizuar në atë regjion;
2. urdhëron marrjen e mostrave në kafshët e dyshuara;
3. urdhëron zbatimin e masave për kufizimin e lëvizjes së kafshëve;
4. ndalon hyrjen e personave të paautorizuar në zonën e dyshuar apo të infektuar;
5. përkufizon zonën e dyshuar apo të infektuar, varësisht nga numri i kafshëve të dyshuara apo të infektuara me këtë sëmundje;
6. ndalon përdorimin e qumështit të kafshëve të sëmura dhe shitjen e produkteve të qumështit dhe nuk lejon tjetërsimin e kafshëve nga ajo zonë;
7. ndalon therjen e kafshëve të dyshuara apo të infektuara dhe përdorimin e mishit të tyre;
8. urdhëron largimin e kufomave të kafshëve dhe asgjësimin e tyre;
9. urdhëron zbatimin e masave për pastrimin e vendit dhe dezinfektimin e vendit-zonës.

(2) Me qëllim të parandalimit të sëmundjes së plasjes, autoriteti kompetent në hapësirën e infektuar apo të dyshuar për paraqitjen e kësaj sëmundje, përveç masave nga paragrafi 1 i këtij neni, urdhëron vaksinimin e kafshëve të mbetura në atë pronë apo pronat për rreth duke e monitoruar situatën dhe duke e vlerësuar rrezikun për paraqitjen e sërishtme të Plasjes në atë pronë dhe në pronat për rreth.

(3) Pronari - mbajtësi i kafshës është i obliguar që të veprojë sipas udhëzimeve dhe urdhërave të autoritetit kompetent.

Neni 4

Në rast të konfirmimit zyrtar të Anthrax-it, autoriteti kompetent është i obliguar që t’i lajmërojë praktikant veterinar, Ministrinë e Shëndetësisë, autoritetet kompetente të shteteve fqinje, Organizatën Ndërkombëtare për Epizooti - OIE, dhe DG-SANCO - Drejtoria Gjenerale për rautje të shëndetit publik dhe mbrojtje të konsumatorit.

Neni 5

Në rast se në një pronë është paraqitur vetëm një rast i Plasjes nuk lejohet lëvizja e kafshëve nga ajo pronë, ndërsa në rast se vërtetohet prania e Plasjes në pronë të ndryshme, përveç ndalimit të lëvizjes së kafshëve, ndalohet edhe lëshimi i certifikatave për gjendjen shëndetësore të kafshëve - përdërisa të ekzistojë rreziku i përhapjes së Plasjes.

Neni 6

Pas kalimit të periudhës prej 14 ditësh nga rasti i fundit të sëmundjes së Plasjes, duke u bazuar në analizat laboratorike të kryera, e të cilat kanë rezultuar negative, autoriteti kompetent mund të lejojë therjen e kafshëve të shëndosha që i përkasin stallës ose kullotës në të cilën është manifestuar kjo sëmundje.

Neni 7

- (1) Kafshët e infektuara me Plasje, duhet të asgjësohen menjëherë, dhe nga ato nuk lejohet heqja e lëkurës dhe e organeve të brendshme.
- (2) Në rast se kafsha është therë dhe pas therjes është dyshuar apo konfirmuar Plasja; lëkura, mishi dhe organet e brendshme të kafshëve, duhet të asgjësohen në mënyrë që të mos vijnë në kontakt me njerëz dhe kafshë.
- (3) Asgjësimi i kafshëve të infektuara me Plasje, bëhet me djegien e kufomës së kafshës në lokacionin e caktuar, në praninë e veterinarit të autorizuar duke mos e ndotur ujin dhe ambientin.
- (4) Djegia bëhet në insenerator (kremator), e në mungesë të tij, djegia e kufomës behët në furrën e druve - duke i vënë lëndë djegëse.
- (5) Mbeturinat, pjesët e ushqimit dhe çdo material tjetër i mbetur pas asgjësimit të kafshëve, merren nga vendi ku kanë qëndruar ato dhe asgjësohen menjëherë me djegie.
- (6) Transporti i kafshëve të ngordhura nga sëmundja e plasjes, bëhet sipas instruksioneve të dhëna nga veterinarit i autorizuar dhe mjeti transportues duhet të jetë i atillë i cili do t'a pamundësojë rënien e kufomës apo pjesëve të saj.

Neni 8

Kompensimi i dëmit

- (1) Për kompensimin e fermerëve, të cilët pësojnë dëm nga asgjësimi i kafshëve të prekura me Plasje, (me përjashtim të qeneve dhe macave), vendos autoriteti kompetent në bazë të legjislacionit në fuqi.
- (2) Në rast se autoriteti kompetent nuk ka mjete buxhetore për kompensim, atëherë përmes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kërkohet nga Qeveria e Kosovës sigurimin e mjeteve.

Neni 9

Zbatimi

- (1) Për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ, Kryeshefi Ekzekutiv i autoritetit kompetent mund të nxjerr vendime të posaçme.
- (2) Moszbatimi i këtij udhëzimi administrativ, do të sanksionohet sipas nenit 45 të Ligjit për Veterinarinë dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 11.03.2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,

Idriz Vehapi